



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/23 Nr. i faq./Br.str./No.pg 46

Data/Datum/Date 30.03.2023

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10, paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2023 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71510057-05539-0 në Zonën Kadastrale Rahovec

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, me Nr. Prot. 02/261/23, i datës 8.3.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-05539-0, në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 100m² (njëqind metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3005m² (tre mijë e pesë metra katror) në vendin e quajtur przhina-iza grobla, me kulturë arë e klasit 4, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Behar (Muharem) Hajdës nga Rahoveci.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të jetë "Këmbimi i pronës private me pronën komunale".
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës, në Librin Kadastral, do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËSNËRAHOVEC

01Nr.46/23
Datë:30.03.2023

